



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1574/8 prot.

Datë 23.06.2026

V E N D I M
Nr. 853/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.06.2026 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-82898-04-22-2026, me objekt: “*Blerje material dhe reagent laboratorikë*”, me fond limit 5,066,420 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 23.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr. 6/337, Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Krijon” SHPK me NIPT (K12023001A) dhe adresë: Rruga e Elbasanit, Collak, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, dhe nenit 4 të Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020
“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e
Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik
gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.04.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-82898-04-22-2026, me objekt: “Blerje material dhe reagent laboratorikë”, me fond limit 5,066,420 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 23.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 04.05.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më

datë 08.05.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Krijon” SHPK	3,798,815 lekë	Skualifikuar
2. “Kej Group” SHPK	3,803,691 lekë	Skualifikuar
3. “Sky Line” SHPK	4,241,609 lekë	Skualifikuar
4. “Isometric” SHPK	4,355,170 lekë	Kualifikuar
5. “Almedical” SHPK	4,498.190 lekë	Kualifikuar

II.4. Në datën 15.05.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi Paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Konkretisht operatori ekonomik “Krijon” SHPK rezulton i skualifikuar për arsyen si më poshtë:

“1. Operatori ekonomik “KRIJON” sh.p.k. me NUIS KI2023001A me dokumentacionin e paraqitur nuk vërteton se plotëson kërkesat e AK të vendosura në DST.

Arsyet e skualifikimit;

Për plotësimin e kërkesave të vecanta për kualifikim pika 2.3.1/b e cila përcakton:

2.3.1/b Operatori ekonomik të paraqesë katalogë/skedë teknike për artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen emërtimet dhe specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe sepcifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me artikujt objekt prokurimi. Kataloget/skeda teknike të jenë të noterizuara dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.

Oe ka paraqitur katalog origjinal si dhe përkthimin e tij nga një përkthyes zyrtar i gjuhës angleze. Nga vlerësimi I produkteve të ofruara në kataloget e ngarkuar në SPE me specifikimet e produkteve të kërkuara nga AK rezulton se për artikullin nr.66 “Refrigerant ftohës” (Refrigerant ftohës Allihyn me 8 bula NS 29/32 me gjatësi 550 mm) OE nuk ka paraqitur katalog ose skedë teknike sic kërkohet në DST por një deklaratë të prodhuesit me përmbajtje si më poshtë:

Normalab

Kujt it interesoje

Deklaratë proshuesi

Në Normalab Francë SAS

Prodhojmë dhe furnizojmë me ftohës qelqi ALLIHN me porosi me 8 llampa, butona NS 29/32, gjatësi:550mm në përputhje me standartet ndërkombëtare. Enët tona të qelqit për laboratorë prodhohen për të përmbushur kërkesat e standarteve (ASTM, ISO...)

Prodhuar sipas kerkese ne Francë

Duke u specializuar në përpunimin e qelqit për më shumë se 60 vjet, ekipi ynë punon për të përmbushur më së miri të gjitha kërkesat tuaja specifike (mare nga përkthimi zyrtar).

Nisur nga kjo KVO vlerëson se:

*Në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit dhe është detyrë e Operatorit Ekonomik të bind AK se oferta e paraqitur I plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kërkesa se “Operatori ekonomik të paraqesë katalogë/skedë teknike për artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen emërtimet dhe specifikimet teknike të tyre në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me artikujt objekt prokurim. Mosparaqitja e tyre nuk I jep mundësi KVO të verifikojë nëse produkti që ofrohet I përmbush kërkesat e AK dhe si rrjedhim OE ka dështuar të bind AK se oferta e tij plotëson kërkesat e vendosura në DST
OE skualifikohet për mospërmbushje të kërkesave të vecanta për kualifikim pika 2.3.1/b.”*

II.5. Në datën 21.05.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/6687, datë 21.05.2026 dhe me nr. protokoli 1574/1 datë 21.05.2026 e operatorit ekonomik “Krijon” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon:

“[...] Së pari, referuar pikës 2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë katalogë/skeda teknike për artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen emërtimet dhe specifikimet teknike të tyre, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e përcaktuara në Shtojcën 6 Formulari i Specifikimeve Teknike.

Shoqëria Krijon sh.p.k., për artikullin nr. 66 Refrigjerant ftohës Allhin me 8 bula NS 29/32 me gjatësi 550 mm, ka ngarkuar në SPE katalog nga faqja zyrtare e prodhuesit Normalab, kompani me seli në Francë, ku specifikohet qartë se shoqëria është e specializuar prej më shumë se 60 vitesh në prodhimin e artikujve të qelqit laboratorik dhe realizon produkte sipas kërkesave specifike të klientëve.

Në përmbushje të kriterit të mësipërm, shoqëria jonë ka komunikuar me prodhuesin Normalab, kompani me të cilën bashkëpunon prej vitesh, dhe ka paraqitur edhe një dokument shtesë lëshuar nga prodhuesi, ku konfirmohet se artikulli objekt prokurimi mund të prodhohet sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, duke respektuar standardet ndërkombëtare përkatëse.

Artikulli objekt prokurimi është produkt laboratorik me përdorim specifik në fushën e testimit të hidrokarbureve nuk përbën një produkt standart tregëtar. Artikulli nr. 66 përbën produkt të

prodhuar me porosi (custom-made), fakt i cili rezulton qartë nga informacioni publik i prodhuesit. (katalog ngarkuar në SPE). Për këtë arsye, për artikullin konkret nuk ekziston katalog standard i publikuar, pasi produkti realizohet mbi bazën e parametrave teknike të kërkuar nga klienti.

Në këto kushte, Autoriteti Kontraktor nuk mund të kufizojë në mënyrë artificiale format e provueshmërisë teknike vetëm në katalogë standardë, veçanërisht për produkte të personalizuar që, për vetë natyrën e tyre, nuk disponojnë katalog publik të gatshëm. Një interpretim i tillë përbën formalizëm të tepruar dhe cenon parimin e proporcionalitetit dhe konkurrencës së lirë në procedurën e prokurimit.

Në shume vendime vetë Komisioni i Prokurimit Publik ka cituar se qëllimi kryesor i vendosjes së kriterëve të kualifikimit është që AK të arrijë të sigurohet se operatori ekonomik do të furnizojë artikujt e kërkuar sipas specifikimeve teknike.

Së dyti, referuar procesverbalit të argumentimit mbi qëllimin e vendosjes së këtij kriteri, gjykojmë se dokumentacioni i lëshuar nga vetë prodhuesi i artikullit i jep Autoritetit Kontraktor garanci të plotë dhe të drejtpërdrejtë se artikulli do të furnizohet në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Qëllimi i kërkesës për paraqitjen e katalogëve apo dokumentacionit teknik është verifikimi i përputhshmërisë së produktit të ofertuar me specifikimet teknike të procedurës. Në rastin konkret dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria jonë përmbush plotësisht këtë funksion verifikues, pasi identifikohet qartë prodhuesi, aktiviteti i tij në fushën e prodhimit të qelqit laboratorik si dhe faktin që produktet realizohen për përdorim specifik laboratorik dhe sipas kërkesave të klinetit.

Dokumenti teknik i ngarkuar ne spe garanton që informacioni i paraqitur është i saktë, i përditësuar, zyrtar dhe i besueshëm, pasi buron drejtpërdrejt nga vetë subjekti që prodhon artikullin. Në deklaratën e ngarkuar në SPE, prodhuesi jo vetëm ka konfirmuar mundësinë e prodhimit të artikullit, por ka specifikuar shprehimisht se artikulli mund të prodhohet sipas parametrave dhe specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Ky dokument përbën provë më të drejtpërdrejtë dhe më specifike sesa katalogu standard apo zyrtar, i cili zakonisht përmban produkte të përgjithshme dhe jo domosdoshmërisht pasqyron produkte të personalizuar apo të prodhuara me porosi.

Së treti, nëse Autoriteti Kontraktor do të kishte pasur dyshime mbi përmbajtjen apo vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga ana jonë, ai kishte mundësinë dhe detyrimin të kryente verifikime të mëtejshme pranë vetë prodhuesit të artikullit, me qëllim konfirmimin e informacionit të paraqitur në dokumentacionin e ofertës.

Referuar parimeve të përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 Për prokurimin publik , Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të garantojë trajtim të barabartë, proporcionalitet dhe zhvillimin e një procedure objektive dhe konkurruese. Gjithashtu, legjisllacioni i prokurimit publik i njeh Autoritetit Kontraktor të drejtën për të kërkuar sqarime dhe për të verifikuar informacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë, kur kjo është e nevojshme për vlerësimin korrekt të ofertës.

Në rastin konkret, në vend që të kryente një verifikim objektiv pranë prodhuesit lidhur me dokumentacionin e paraqitur, Autoriteti Kontraktor ka proceduar menjëherë me skualifikimin e

ofertës sonë, megjithëse është provuar në mënyrë të arsyeshme përputhshmëria e artikullit me specifikimet teknike të procedurës.

Mosrealizimi i një verifikimi të tillë përbën qasje jo proporcionale, në kundërshtim me parimet e ligjit për prokurimin publik, pasi qëllimi i procedurës duhet të jetë identifikimi i ofertës ekonomike më të favorshme dhe jo skualifikimi mbi baza formale, kur informacioni teknik mund të verifikohet lehtësisht pranë vetë prodhuesit.

Së katërti, për sa kohë që katalogët dhe skedat teknike janë dokumente të lëshuara nga vetë prodhuesi, me qëllim prezantimin, reklamimin dhe specifikimin teknik të produkteve që ai prodhon apo ofron në treg, nuk ekziston asnjë bazë ligjore që ta bëjë të pavlefshme një broshurë, dokument të marrë nga ëeb-i , apo deklaratë teknike të lëshuar po nga vetë prodhuesi, veçanërisht kur bëhet fjalë për një produkt të prodhuar me porosi (custom-made).

Në thelb, për aq kohë sa këto dokumente krijohen nga vetë prodhuesi dhe kanë të njëjtin qëllim, pra të evidentojnë dhe promovojnë produktin si edhe specifikimet teknike të tij, atëherë autoriteti kontraktues nuk duhet të kufizohet në emërtimin formal të dokumentit (katalog , skede teknike broshurë , datasheet , technical data sheet etj.), por duhet të vlerësojë përmbajtjen dhe aftësinë reale të dokumentacionit për të provuar përputhshmërinë e produktit me specifikimet teknike të kërkuara në procedurën e prokurimit.

Nga sa më sipër gjykojmë se nuk jemi në rastin e mospërmbushjes së kritereve kualifikuese, konkretisht të pikës 2.3.1/b. Për rrjedhojë, kërkojmë rishikimin e vendimit të skualifikimit dhe kualifikimin e ofertës sonë, pasi dokumentacioni i paraqitur provon në mënyrë të plotë përmbushjen e kritereve të kualifikimit.”

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1574/2 prot, datë 22.05.2026, lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Krijon” SHPK kundërshton me anë të ankimit të tij.

II.7. Në datë 01.06.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, autoriteti kontraktor ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës, me nr.1965/6 prot., datë 01.06.2026, protokolluar me tonën me nr.1574/3 prot., datë 01.06.2026.

II.8. Me anë të shkresës Nr.1965/7 prot., datë 01.06.2026, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr.1574/4 prot., datë 02.06.2026, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës Nr.88/2026, datë 01.06.2026, ku konstatohet se ankesa e operatorit ekonomik ankimues është refuzuar.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk në datë 09.06.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronik, operatori ekonomik “Krijon” SHPK ka paraqitur argumente, në lidhje me trajtimin e ankesës së tij nga KSHA.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “[...] Shoqëria Krijon sh.p.k., për artikullin nr. 66 Refrigjerant ftohës Allhin me 8 bula NS 29/32 me gjatësi 550 mm, ka ngarkuar në SPE katalog nga faqja zyrtare e prodhuesit Normalab, kompani me seli në Francë, ku specifikohet qartë se shoqëria është e specializuar prej më shumë se 60 vitesh në prodhimin e artikujve të qelqit laboratorik dhe realizon produkte sipas kërkesave specifike të klientëve.

Në përmbushje të kriterit të mësipërm, shoqëria jonë ka komunikuar me prodhuesin Normalab, kompani me të cilën bashkëpunon prej vitesh, dhe ka paraqitur edhe një dokument shtesë lëshuar nga prodhuesi, ku konfirmohet se artikulli objekt prokurimi mund të prodhohet sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, duke respektuar standardet ndërkombëtare përkatëse.

Artikulli objekt prokurimi është produkt laboratorik me përdorim specifik në fushën e testimit të hidrokarbureve nuk përbën një produkt standart tregëtar. Artikulli nr. 66 përbën produkt të prodhuar me porosi (custom-made), fakt i cili rezulton qartë nga informacioni publik i prodhuesit. (katalog ngarkuar në SPE). Për këtë arsye, për artikullin konkret nuk ekziston katalog standart i publikuar, pasi produkti realizohet mbi bazën e parametrave teknike të kërkuar nga klienti.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2 e dokumenteve të tenderit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar shprehimisht:

2. Operatori ekonomik të paraqesë katalogë/skedë teknike për artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen emërtimet dhe specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me artikujt objekt prokurimi. Kataloget/skeda teknike të jenë të noterizuara dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.

III.1.2. Ndërkohë në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të tenderit është përcaktuar:

66	Refrigjerant ftohës	Refrigjerant ftohës Allihyn me 8 bula NS 29/32 me gjatësi 550 mm	copë
----	---------------------	--	------

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Krijon” ShPK, rezulton, se në përmbushje të kriterit të sipërcituar, është dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, dokumentacioni si më poshtë:

- Katalog 2 në të brendësi të të cilit gjendet dokumenti:
 - i) Deklaratë nga prodhuesi Normalab, datë 29.04.2026 e përkthyer dhe noterizuar, me përmbajtje si më poshtë: *“Ne prodhojmë dhe furnizojmë me ftohës qelqi ALLIHN me porosi me 8 llamba, bulona NS 29/32, gjatësi: 550 mm. Në përputhje me standartet ndërkombëtare”.*
 - ii) Pritscreen të faqes ëeb (<https://normalab.com>) të prodhuesit Normalab, e përkthyer dhe noterizuar me përmbajtje: *“Enët tona prej qelqi për laborator prodhohen për të përmbushur kërkesat e standarteve (ASTM, ISO...) Prodhuar sipas kërkesës në Francë Duke u specializuar në përpunimin e qelqit për më shumë se 60 vjet, ekipi ynë punon për të përmbushur më së miri të gjitha kërkesat tuaja specifike.”*

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.5. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.6. Në nenin 36 “*Specifikimet teknike*” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.1.7. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.8. Në nenin 40, pika 6 dhe 8 të VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si

informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

III.1.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që “Operatori ekonomik të paraqesë katalogë/skedë teknike për artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen emërtimet dhe specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe sepcifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me artikujt objekt prokurimi. Kataloget/skeda teknike të jenë të noterizuara dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.

III.1.11. Nisur nga arsyeja e skualifikimit, si dhe pretendimet e vetë ankimuesit, i cili në ankesën e tij deklaron se për për artikullin Nr.66 *“Refrigerant ftohës”*, ka dorëzuar një deklaratë nga prodhuesi Normalab, datë 29.04.2026 e përkthyer dhe noterizuar, me përmbajtje si më poshtë: *“Ne prodhojmë dhe furnizojmë me ftohës qelqi ALLIHN me porosi me 8 llamba, bulona NS 29/32, gjatësi: 550 mm. Në përputhje me standartet ndërkombëtare”*, si dhe Pritscreen të faqes ëeb (<https://normalab.com>) të prodhuesit Normalab, e përkthyer dhe noterizuar me përmbajtje: *“Enët tona prej qelqi për laborator prodhohen për të përmbushur kërkesat e standarteve (ASTM, ISO...), Prodhuar sipas kërkesës në Francë. Duke u specializuar në përpunimin e qelqit për më shumë se 60 vjet, ekipi ynë punon për të përmbushur më së miri të gjitha kërkesat tuaja specifike.”*

Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm, në përmbushje të kriterit të kualifikimit pika 2 të *“Kapacitetit teknik”*, si dhe arsyes së skualifikimit, konstatohet se nuk është dorëzuar asnjë katalog apo skedë teknike të prodhuesit, për artikullin Nr.66 *“Refrigerant ftohës”*, ku të jenë të markuara specifikimet teknike, siç kërkohet në dokumentat e tenderit.

Operatori ekonomik, ka paraqitur një deklaratë të prodhuesit, i cili nuk është katalog apo skedë teknike, si dhe ka paraqitur një Pritscreen të faqes ëeb (<https://normalab.com>) të prodhuesit Normalab, ku nuk gjejnë pasqyrim artikulli Nr.66 *“Refrigerant ftohës”*, si dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Pra, sa më sipër, nisur nga arsyet e skualifikimit, por edhe vetë pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në ankesën e tij, si dhe verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky i fundit në SPE, në përmbushje të kriterëve të kualifikimit, konstatohet se dokumentacioni i dorëzuar për artikullin Nr.66 *“Refrigerant ftohës”*, nuk është i plotë dhe në përputhje me pikën 2 të *“Kapacitetit teknik”*, të dokumentave të tenderit.

III.1.12. KPP sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.13. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë fizike dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Krijon” SHPK nuk

ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, në pikën 2 të “*Kapacitetit teknik*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në lidhje me artikullin Nr.66 “*Refrigerant ftohës*”.

III.1.14. KPP gjykon, se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

III.1.15. Gjithashtu, Komisioni sqaron, se nëse operatori ekonomik do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar në të cilin parashikohet se “*1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*” Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se “*1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*

Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...].

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Krijon” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-82898-04-22-2026, me objekt: “Blerje material dhe reagent laboratorikë”, me fond limit 5,066,420 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 23.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

